



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksioni i rrugës paralele me pedonalen e Dhërmiut dhe trotuar”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45233120-6 Punime ndërtimi për rrugë

VLERA E FONDIT: 88,333,333 (tetedhjetë e tete milion e treqinde e tridhjetë e tre mijë e treqinde e tridhjetë e tre lekë) **pa TVSH**, vënë në dispozicion nga **buxheti i Bashkisë Himarë** i ndarë në dy vite financimi, konkretisht:

- **Viti 2026 41,666,667** (dyzetë e një milion e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e shtatë lekë) **pa TVSH**.

- **Viti 2027 46,666,666** (dyzetë e gjashtë milion e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqinde e gjashtedhjetë e gjashtë lekë) **pa TVSH**

Perilogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*

b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entiktraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter

kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontrates.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** dhe **2026** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, neni 26 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, pika 6 “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese*”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “*Per procedurat tatimore*” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “*Per QKB*” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “*Per QKR*” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

I. Kontratën e Sipërmarrjes,

II. Situacionin përfundimtar të objektit

III. Faturat Tatimore të miratuar sipas legjislacionit tatimor të delaruara në organet tatimore

IV. Aktin e Kolaudit të objektit

V. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

VI. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b). Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- I. Kontratën e Sipërmarrjes,
- II. Situacionin përfundimtar të objektit
- III. Aktin e Kolaudimit të objektit
- IV. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve huridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

NP.1 – Punime germimi në tokë

Klasifikimi A

NP.4 – Rruge autostrada, ura, etj

Klasifikimi D

NP. 12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit

Klasifikimi A

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NS –1 – Punime për prishjen e ndërtimeve	Klasifikimi A
- NS – 5 – Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut	Klasifikimi A
- NS – 6 – Sinjalistika rugore jo ndriçuese	Klasifikimi A
- NS – 7 – Barrierra dhe mbrojtje rrugore	Klasifikimi A
- NS – 8 – Nderime betonarme parafabrikat, struktura metalike	Klasifikimi A
- NS – 18 – Punime topogjeodezike	Klasifikimi A

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se liçensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Gërmim me krahe në seksion të detyruar me gjerësi $b > 1$ m, $h=1.5$ m, tokë e zak. Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m ³ , në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria IV, me shk në mjet Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ ,	A	0-21 milion

		ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet Transport dheu me auto deri 5.0 km Prerje bime te vogla $\varnothing \sim 10\text{cm}$		
NP.4	Rruge autostrada, ura, etj	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri Mbushje me zhavorr ne trupin e rruges, perhapur me makineri (me ngjeshje cdo 20 cm) Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri Shtrese çakelli mbeturine kave $t=20\text{cm}$, perhapur e ngjeshur me makineri Shtrese stabilizant $t=10\text{cm}$ Cilindrim kasonete me rul Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka F.V. Bordura betoni $15 \times 30\text{cm}$ F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 $d=315\text{ mm}$ F.V. Tuba PVC $f=200\text{ mm}$ te brinjezuar F.V. Tub kanalizimi pvc $\varnothing 90$ F.v tub fi 63 per linjat e ndricimit Shtrese rere Mbushje me zhavorr pas mureve	D	101 - 200 milion
NS.1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje struktura prej betoni Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri Prishje shtrese çakelli $t = 15\text{ cm}$, me makineri	A	0-21 milion
NS.5	Impiante të sinjalistikës ndriçuese	3.942/1 Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (	A	0-21 milion

	të trafikut	paste) 3.946/2 Vijeimet e kalimit te kembesoreve. Akrelike		
NS.6	Sinjalistika rugore jo ndriçuese			
NS.7	Sinjalistika Rrugore Jondricuese	3.955 F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	A	0-21 milion
NS.8	Ndertime betonarme parafabrikat, struktura metalike	3.242 Struktura monolite betoni C 12/15 3.244 Struktura monolite betoni C 20/25 3.245 Struktura monolite betoni C 25/30 3.239 Struktura monolite betoni C 7/10 3.240 Struktura monolite betoni C 12/15 3.618 F.V. Bordura betoni 20x35 cm 3.620 Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	A	0-21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	3.969 Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri 3.197/1 Prishje shtrese çakelli t = 15 cm, me makineri 3.211 Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri 3.212/b Shtrese stabilizant t=10cm 3.164/1b Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri 3.211 Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri 3.104/b Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet 3.45/1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² 3.104/b Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet 3.45/1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² 3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.45/1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² 3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.45/1 Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² 3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.44/1 Germim kanalesh ne toke te bute,	D	101 - 200 milion

		me krahe, me seksion deri 0.75 m ² 3.89/a Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 3.44/1 Germim kanalesh ne toke te bute, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²		
--	--	--	--	--

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente (te vlefshme)

ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ose ekuivalente (te vlefshme)

ISO 39001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor (te vlefshme)

ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë ose ekuivalente (te vlefshme)

PAS 99:2012 : për Sistemin e menaxhimit të integruar (te vlefshme)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit

dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Himare si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësisë ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Himare si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- **Për ISO 39001:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor** është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me standardin **ISO 39001:2012**, ose ekuivalent, standart i cili përcakton kërkesat për një Sistem të Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor. Kërkesa për këtë standart lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, **transportin rrugor**, pasi realizimi i shërbimit përfshin përdorimin e mjeteve të transportit dhe zhvillimin e aktivitetit në rrjetin rrugor. Për këtë arsye, siguria rrugore përbën një element thelbësor për realizimin e kontratës në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.

Certifikimi sipas standardit ISO 39001:2012 dëshmon se operatori ekonomik ka të ngritur një sistem të strukturuar për **identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të sigurisë rrugore, parandalimin dhe reduktimin e aksidenteve, kontrollin e faktorëve që ndikojnë në sigurinë e transportit, monitorimin e performancës së sigurisë rrugore dhe përmirësimin e vazhdueshëm të masave të sigurisë.**

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktor synon të sigurojë që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet organizative dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e aktivitetit të transportit rrugor me standarde të përshtatshme sigurie, duke synuar minimizimin e rrezikut të aksidenteve dhe mbrojtjen e drejtuesve të mjeteve, pasagjerëve, përdoruesve të tjerë të rrugës dhe palëve të treta.

Për rrjedhojë, kërkesa për **ISO 39001:2012, ose ekuivalent**, konsiderohet e lidhur dhe proporcionale me natyrën e objektit të prokurimit, pasi garantimi dhe menaxhimi sistematik i sigurisë rrugore është pjesë e rëndësishme e ofrimit të një shërbimi transporti rrugor të sigurt dhe cilësor.

- **Per ISO 45001:2018** Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikën, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare.

- **Për PAS 99:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Integruar**

Është kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me **PAS 99:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Integruar**, të vlefshëm, ose ekuivalent, me qëllim garantimin e një sistemi të organizuar dhe të integruar të menaxhimit të proceseve që lidhen me realizimin e objektit të kontratës.

PAS 99:2012 përcakton një kuadër të përbashkët për integrimin e kërkesave të sistemeve të ndryshme të menaxhimit brenda një strukture të vetme organizative. Zbatimi i tij mundëson koordinimin e politikave, procedurave, përgjegjësisë, kontrollit të rreziqeve, monitorimit të performancës dhe procesit të përmirësimit të vazhdueshëm.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me **transportin rrugor**, realizimi i shërbimit kërkon koordinim të vazhdueshëm ndërmjet menaxhimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë rrugore, mbrojtjes së mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe menaxhimit të rreziqeve që shoqërojnë aktivitetin e transportit. Për këtë arsye, një sistem i integruar menaxhimi ndihmon operatorin ekonomik në administrimin e këtyre proceseve në mënyrë të unifikuar, të kontrolluar dhe të dokumentuar.

Kërkesa për **PAS 99:2012, të vlefshëm, ose ekuivalent**, synon të sigurojë se operatori ekonomik disponon kapacitete organizative dhe procedura të përshtatshme për integrimin dhe koordinimin e sistemeve të menaxhimit që lidhen me ekzekutimin e kontratës, duke reduktuar mbivendosjen e proceseve, përmirësuar kontrollin e rreziqeve dhe rritur efektivitetin e menaxhimit të shërbimit.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë lidhet me nevojën e Autoritetit Kontraktor për të garantuar një **menaxhim të integruar, të qëndrueshëm dhe të kontrolluar të aktivitetit të transportit rrugor**, në funksion të realizimit me cilësi, siguri dhe përgjegjshmëri të objektit të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **40 (dyzetë) punonjës**, me kohë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, *dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **40 (dyzetë) punonjës**, për të paktën 3 muajt e fundit. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për 3 (tre) muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të

kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën **40 (dyzetë) punonjës** duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar në këto elementet e struktura të kostos (material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nëligjore.

mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libere pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:
- Minimuni **1(një) Inxhinier Ndërtimi**
 - Minimuni **2(dy) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshejder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.” Kërkesa për 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatësë lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve

të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

2.Inxhinieri i Ndërtimit Profili Transport është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, duke siguruar zbatimin e saktë të projektit dhe duke pasur parasysh Specifikimet Teknike dhe projektin e miratuar.

4.Inxhinier Gjeodet/Topograf/ Markshejder, është përgjegjës për dhe do të kryejë azhurnimin topografik dhe piketimin e objektit ndërtimor, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhurnimin faktit (as built). Ky inxhinier është i nevojshëm për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi	jo me pak se 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik	jo me pak se 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	jo me pak se 1 (një)
- Inxhinier Elektrik	jo me pak se 1 (një)
- Inxhinier Mekanik	jo me pak se 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog	jo me pak se 1 (një)

Per punonjesit e mesiperme duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf duhet diplome të shkollës së mesme profesionale
- Te gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperme , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka lëshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me sipër.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinier Ndërtimi – jo më pak se 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi argumentohet me nevojën për drejtimin, organizimin dhe mbikëqyrjen teknike të punimeve të ndërtimit të infrastrukturës rrugore. Këta specialistë janë të nevojshëm për ndjekjen e punimeve të shtresave rrugore, nënshtresave, elementeve konstruktive dhe veprave të tjera të parashikuara në projekt, si dhe për kontrollin e zbatimit të projektit, specifikimeve teknike dhe cilësisë së punimeve. Numri prej dy specialistësh justifikohet me volumin dhe zhvillimin paralel të proceseve të ndryshme të punës, duke mundur mbulimin efektiv të kantierit dhe vazhdimësinë e kontrollit teknik.

Inxhinier Hidroteknik – jo më pak se 1 (një)

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve që lidhen me sistemin e largimit dhe administrimit të ujërave, drenazhimit e trupit të rrugës, tombinot, kanalet, veprat e shkarkimit dhe elementet e tjera hidroteknike. Prania e këtij specialisti është e rëndësishme për garantimin e funksionimit të sistemeve të kullimit dhe mbrojtjen e infrastrukturës rrugore nga dëmtimet që mund të shkaktohen nga ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore.

Inxhinier Mjedisit – jo më pak se 1 (një)

Inxhinieri i Mjedisit kërkohet për menaxhimin dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore gjatë realizimit të punimeve, përfshirë administrimin e mbetjeve, kontrollin e pluhurave dhe zhurmave, mbrojtjen e tokës dhe ujërave, si dhe zbatimin e masave për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative në mjedis. Ky specialist siguron që proceset e punës të zhvillohen në përputhje me kërkesat dhe masat mjedisore të zbatueshme për objektin.

Inxhinier Elektrik – jo më pak se 1 (një)

Inxhinieri Elektrik kërkohet për organizimin dhe ndjekjen e punimeve elektrike që mund të jenë pjesë e infrastrukturës rrugore, si ndriçimi rrugor, linjat e furnizimit me energji, panelet elektrike, instalimet dhe sistemet e tjera elektrike të parashikuara në projekt. Ky specialist garanton

realizimin dhe kontrollin teknik të këtyre punimeve në përputhje me projektin dhe kërkesat teknike përkatëse.

Inxhinier Mekanik – jo më pak se 1 (një)

Inxhinieri Mekanik kërkohet për menaxhimin dhe kontrollin teknik të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve mekanike që përdoren gjatë realizimit të punimeve, si dhe për komponentët apo instalimet mekanike që mund të përfshihen në objekt. Angazhimi i tij kontribuon në përdorimin e përshtatshëm, funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknike të nevojshme për realizimin e punimeve.

Inxhinier Gjeolog – jo më pak se 1 (një)

Inxhinieri Gjeolog kërkohet për vlerësimin dhe ndjekjen e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit ku realizohen punimet. Ky specialist është i nevojshëm veçanërisht për problematikat që lidhen me karakteristikat e formacioneve të tokës, stabilitetin e skarpave, gërmimet, mbushjet, qëndrueshmërinë e bazamentit të rrugës dhe evidentimin e kushteve të paparashikuara gjeologjike gjatë zbatimit të punimeve.

Në tërësi, kërkesa për këto profile profesionale synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë në dispozicion **kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve të infrastrukturës rrugore**, duke siguruar organizimin e duhur të kantierit, kontrollin teknik, cilësinë, sigurinë dhe respektimin e kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike.

Numri dhe profilet e specialistëve të kërkuar janë përcaktuar në raport me natyrën, kompleksitetin dhe proceset teknike që përfshin realizimi i objektit të kontratës, me qëllim garantimin e kapaciteteve të nevojshme profesionale për përmbushjen me sukses të saj.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjes të certifikuar me dëshmi trajnimi si “*Specialist per sigurimin teknik dhe shëndetin ne pune*” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM

Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë", sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkepunitimit.

Argumentimi: Specialist për Sigurinë Teknike dhe Shëndetin në Punë – jo më pak se 1 (një) Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) **Specialisti për Sigurinë Teknike dhe Shëndetin në Punë** është e nevojshme dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të objektit të kontratës, pasi realizimi i punimeve në infrastrukturën rrugore përfshin procese pune me rrezik të shtuar, përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të rënda, punime gjurmimi dhe mbushjeje, transport dhe lëvizje të mjeteve të tonazhit të rëndë, si dhe zhvillimin e punimeve në zona ku mund të ketë qarkullim të mjeteve dhe këmbësorëve.

Specialisti për Sigurinë Teknike dhe Shëndetin në Punë është i nevojshëm për **identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, përcaktimin dhe monitorimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse, kontrollin e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes individuale dhe kolektive, informimin dhe udhëzimin e personelit, si dhe monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë gjatë zhvillimit të punimeve.**

Gjithashtu, ky specialist do të kontribuojë në organizimin e sigurt të kantierit, sinjalizimin dhe kufizimin e zonave të rrezikshme, parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në punë dhe marrjen e masave për mbrojtjen e punonjësve dhe personave të tretë që mund të ndikohen nga zhvillimi i punimeve.

Për rrjedhojë, kërkesa për këtë specialist konsiderohet e lidhur me objektin e kontratës dhe e nevojshme për garantimin e zbatimit të masave të **sigurisë teknike dhe mbrojtjes së shëndetit në punë gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve**, me synim parandalimin e rreziqeve profesionale, aksidenteve dhe krijimin e kushteve të sigurta të punës në kantier.

- b) 1 (një)** punonjes i pajisur me çertifikate "*Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave*" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- c) 1 (një) punonjes të certifikuar “*Ekspert Zjarrfikës*” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “*Ekspert Zjarrfikës*”, në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, është vendosur në funksion të garantimit të zbatimit të kërkesave ligjore dhe teknike që lidhen me mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë e objekteve gjatë realizimit të kontratës.

Objekti i kontratës përfshin punime dhe instalime për të cilat është e nevojshme vlerësimi dhe mbikëqyrja e masave të mbrojtjes nga zjarri, me qëllim që zgjidhjet teknike të zbatuara të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, normat teknike dhe standardet e sigurisë.

Prania e një eksperti të certifikuar zjarrfikës garanton:verifikimin e përputhshmërisë së punimeve me kërkesat e mbrojtjes nga zjarri;identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të cenojnë sigurinë e objektit dhe përdoruesve të tij; zbatimin korrekt të masave parandaluese dhe mbrojtëse ndaj rrezikut të zjarrit; asistencën teknike gjatë realizimit të punimeve dhe koordinimin me institucionet kompetente kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi. Kërkesa që certifikata/dëshmia të jetë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, si autoriteti përgjegjës për certifikimin e ekspertëve të mbrojtjes nga zjarri, synon të garantojë vlefshmërinë ligjore dhe kompetencën profesionale të specialistit të propozuar. Gjithashtu, kërkesa për paraqitjen e diplomës dhe kontratës së punës ose kontratës së bashkëpunimit ka për qëllim të provojë jo vetëm kualifikimin profesional të specialistit, por edhe disponueshmërinë reale të tij për realizimin e kontratës.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën e punimeve që do të realizohen dhe nuk cenon parimin e konkurrencës, pasi bazohet në kërkesa të përcaktuara nga legjislacioni sektorial në fuqi dhe synon garantimin e sigurisë publike, mbrojtjen e jetës dhe të pronës.

- d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

-Teknik Ndërtimi	jo me pak se 4 (katër)
- Elektricist	jo me pak se 4 (katër)
- Punonjës Hidraulik	jo me pak se 3 (tre)
- Punonjës Betonues	jo me pak se 3 (tre)
- Punonjës Hekurthyes	jo me pak se 2 (dy)
- Punonjës Murator/Suvatues	jo me pak se 2 (dy)
- Punonjës Karpentier	jo me pak se 2 (dy)
-Konstruksione Metalike Montator	jo me pak se 2 (dy)
-Punime ne lartesi	jo me pak se 2 (dy)
-Punime ne rruge Asfaltim	jo me pak se 2 (dy)
-Specialist Ndertimi	jo me pak se 2 (dy)
-Drejtues të makinave të rënda (eskavatorist/buldozerist/automashinist)	jo me pak se 3 (tre)
-Shofer te pajisur me leje drejtimi te Kategorise-B” lëshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.	jo me pak se 4 (katër)

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik

ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi te Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilin te deklaruar per cdo punojes.
- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi.
- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët janë te nevojshem per shkak te makinerive te ndryshme qe do te kryejne punime germimi, ngjeshje materiali etj.

Argumentimi i personelit teknik dhe punonjësve të specializuar

Në funksion të realizimit në kohë, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat teknike të objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel teknik dhe punonjës të specializuar sipas profileve të mëposhtme. Këto kërkesa lidhen me natyrën e punimeve të infrastrukturës rrugore, proceset e ndryshme teknologjike që duhet të realizohen, si dhe nevojën për zhvillimin paralel dhe të koordinuar të tyre.

Teknik Ndërtimi – jo më pak se 4 (katër)

Kërkesa për 4 (katër) Teknikë Ndërtimi lidhet me nevojën për organizimin dhe ndjekjen e përditshme të proceseve të punës në kantier, kontrollin e zbatimit të detajeve teknike, matjeve dhe volumeve, koordinimin e grupeve të punës dhe asistimin e stafit inxhinierik. Numri i kërkuar mundëson mbulimin e fronteve të ndryshme të punës dhe zhvillimin paralel të proceseve ndërtimore.

Elektricitist – jo më pak se 4 (katër)

Elektricitistët kërkohen për realizimin e punimeve elektrike të parashikuara në projekt dhe preventiv, përfshirë instalimin e linjave, kablllove, ndriçimit rrugor, lidhjeve, paneleve dhe elementeve të tjera elektrike. Numri prej 4 (katër) punonjësish synon krijimin e kapacitetit të nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike në disa pozicione ose fronte pune.

Punonjës Hidraulik – jo më pak se 3 (tre)

Punonjësit hidraulikë janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që lidhen me tubacionet, pusetat, sistemet e drenazhimit, shkarkimin e ujërave dhe elementet e tjera hidraulike të parashikuara në projekt. Kërkesa për 3 (tre) punonjës mundëson organizimin e një grupi pune të aftë për montimin, lidhjen dhe ndërhyrjet në sistemet përkatëse.

Punonjës Betonues – jo më pak se 3 (tre)

Punonjësit betonues kërkohen për realizimin e proceseve të betonimit të elementeve të ndryshme të veprës, përgatitjen dhe hedhjen e betonit, vibrimin, nivelimin dhe trajtimin e tij, sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike. Numri i kërkuar lidhet me nevojën për krijimin e një grupi funksional për realizimin e proceseve të betonimit.

Punonjës Hekurthyes – jo më pak se 2 (dy)

Punonjësit hekurthyes kërkohen për përgatitjen, prerjen, përkuljen, montimin dhe lidhjen e armaturës së çelikut për elementet prej betoni të armuar të parashikuara në projekt. Disponimi i të paktën 2 (dy) punonjësve siguron realizimin e këtyre proceseve në mënyrë të koordinuar dhe në përputhje me detajet konstruktive.

Punonjës Murator/Suvatues – jo më pak se 2 (dy)

Këta punonjës kërkohen për realizimin e punimeve të muraturës, suvatimit, riparimeve dhe punimeve të tjera të ngjashme që parashikohen në objekt. Numri prej 2 (dy) punonjësish krijon kapacitetin minimal të një grupi pune për realizimin e këtyre zërave.

Punonjës Karpentier – jo më pak se 2 (dy)

Karpentierët kërkohen për realizimin dhe montimin e kallëpeve të nevojshme për elementet prej betoni dhe betonarmeje, si dhe për proceset e tjera të karpenterisë të parashikuara gjatë zbatimit të punimeve. Kërkesa për 2 (dy) punonjës lidhet me nevojën për përgatitjen dhe montimin në mënyrë të sigurt të kallëpeve.

Montator i Konstruksioneve Metalike – jo më pak se 2 (dy)

Këta specialistë kërkohen për montimin, pozicionimin, bashkimin dhe fiksimin e elementeve dhe konstruksioneve metalike që janë pjesë e projektit, përfshirë elementet mbrojtëse, mbajtëse apo struktura të tjera metalike. Numri prej 2 (dy) punonjësish mundëson kryerjen e sigurt dhe të koordinuar të proceseve të montimit.

Punonjës për Punime në Lartësi – jo më pak se 2 (dy)

Punonjësit e kualifikuar për punime në lartësi kërkohen për realizimin e atyre proceseve të objektit që zhvillohen mbi nivelin e zakonshëm të punës dhe që kërkojnë masa të posaçme sigurie. Këta punonjës janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kërkesat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përdorimin e pajisjeve përkatëse mbrojtëse.

Punonjës për Punime Rrugore/Asfaltim – jo më pak se 2 (dy)

Këta punonjës kërkohen për realizimin e proceseve specifike të ndërtimit dhe rehabilitimit të shtresave rrugore, veçanërisht për shtrimin, nivelimin dhe sistemimin e përzierjeve asfaltike dhe proceset ndihmëse që shoqërojnë asfaltimin. Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit si infrastrukturë rrugore.

Specialist Ndërtimi – jo më pak se 2 (dy)

Specialistët e ndërtimit kërkohen për realizimin e proceseve të përgjithshme dhe të specializuara ndërtimore, mbështetjen e grupeve të punës dhe kryerjen e ndërhyrjeve që kërkojnë njohuri dhe eksperiencë praktike në fushën e ndërtimit. Numri prej 2 (dy) specialistësh synon të sigurojë vazhdimësinë dhe mbështetjen teknike të proceseve të ndryshme të punës.

Drejtues të makinerive të rënda (eskavatorist/buldozerist/automakinist) – jo më pak se 3 (tre)

Kërkesa për 3 (tre) drejtues të makinerive të rënda lidhet me përdorimin e makinerive të nevojshme për gërmime, ngarkim-shkarkim, nivelim, sistemim, mbushje, ngjeshje dhe procese të tjera mekanizuara të punimeve rrugore. Numri i kërkuar mundëson përdorimin dhe operimin e makinerive të ndryshme të kantierit sipas grafikut dhe fronteve të punës.

Shoferë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë “B” – jo më pak se 4 (katër)

Kërkesa për 4 (katër) shoferë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë “B”, të lëshuar nga autoriteti kompetent, lidhet me nevojën për lëvizjen e personelit, mjeteve të punës dhe kryerjen e shërbimeve mbështetëse ndërmjet kantierit, bazës së operatorit dhe pikave të ndryshme të punës. Numri i kërkuar synon të garantojë mbështetjen logjistike dhe vijueshmërinë e aktivitetit gjatë realizimit të kontratës.

Argumentimi i numrit të punonjësve

Përcaktimi i numrit minimal të punonjësve për secilin profil është bërë duke marrë në konsideratë **volumin e punimeve, natyrën dhe kompleksitetin e tyre, numrin e proceseve**

teknologjike, nevojën për zhvillimin paralel të disa fronteve të punës dhe afatin e realizimit të kontratës.

Disponimi i këtij personeli synon të sigurojë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe operacional të operatorit ekonomik për realizimin e objektit sipas projektit, preventivit, specifikimeve teknike dhe grafikut të punimeve.

Kërkesat për personelin duhet të konsiderohen të lidhura ngushtë me zërat konkretë të preventivit dhe proceset që do të realizohen, në mënyrë që kriteret e kualifikimit të jenë të justifikuara dhe proporcionale me objektin dhe përmasat e kontratës.

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Mjetet/ makineri dhe pajisje	Pronësia	Sasia
1	Minieskavator me zinxhir gome	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
2	Kamion me vinc	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
3	Kamion vetshkarkues	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
4	Kamioncine 2.5 – 7.5 Ton	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
5	Eskavator me zinxhir	Pronesi ose me qera	1(nje) cope
6	Eskavator me gome	Pronesi ose me qera	2 (dy)cope
7	Fadrome me goma	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
8	Minifadrome	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
9	Kontenier	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
10	Gjenerator kantieri	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
11	Betoniere kantieri	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
12	Vibrues	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
13	Vibrator Pllakash	Pronesi ose me qera	1 (nje)cope
14	Matrapik	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
15	Karroca dore	Pronesi ose me qera	5 (pese) cope
16	Nivelues Betoni	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope

17	GPS Base and Rover	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
18	Autobitumatrice	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
19	Autobot uji	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
20	Asfaltoshtruese	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
21	Asfaltoopererese	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
22	Autobetoniere	Pronesi ose me qera	2 (dy) cope
23	Kamion Pompe Betoni	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
24	Rimorkiator	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
25	Rul hekur hekur	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope
26	Rul gome hekur	Pronesi ose me qera	1 (nje) cope

Argumentimi i makinerive, mjeteve dhe pajisjeve teknike

Në funksion të realizimit të objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar makineritë, mjetet dhe pajisjet minimale të nevojshme, duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të infrastrukturës rrugore, proceset teknologjike, volumin e punimeve, nevojën për transport, gjermim, ngarkim-shkarkim, betonim, asfaltim dhe ngjeshje, si dhe realizimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar. Mjetet dhe pajisjet mund të disponohen **në pronësi ose me qira**, me qëllim garantimin e kapacitetit teknik të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës.

1. Miniekskavator me zinxhir gome – 2 (dy) copë

Kërkohet për realizimin e gjermimeve në hapësira të kufizuara, hapjen e kanaleve, punimet për rrjetet nëntokësore, sistemet dhe gjermimet pranë strukturave ekzistuese. Zinxhirët e gomës mundësojnë punën në sipërfaqe ku kërkohet reduktimi i dëmtimit të shtresave ekzistuese. Sasia prej 2 (dy) copësh lidhet me mundësinë e zhvillimit paralel të punimeve në fronte të ndryshme.

2. Kamion me vinç – 2 (dy) copë

Kërkohet për transportimin, ngritjen, shkarkimin dhe pozicionimin e materialeve dhe elementeve të rënda, si tuba, puseta, elemente metalike, pajisje dhe materiale të tjera ndërtimore. Dy mjete mundësojnë furnizimin dhe shërbimin paralel të fronteve të punës.

3. Kamion vetëshkarkues – 2 (dy) copë

Kërkohet për transportimin dhe shkarkimin e materialeve të gjermimit, inerteve, çakullit, agregateve dhe materialeve të tjera që lidhen me ndërtimin e trupit të rrugës. Sasia prej 2 (dy) copësh siguron vazhdimësinë e ciklit ngarkim–transport–shkarkim.

4. Kamionçinë 2.5–7.5 ton – 2 (dy) copë

Kërkohet për transportin e materialeve, veglave, pajisjeve dhe elementeve ndihmëse ndërmjet bazës dhe fronteve të punës. Dy mjete mundësojnë mbështetjen logjistike të proceseve që zhvillohen njëkohësisht në kantier.

5. Eskavator me zinxhir – 1 (një) copë

Është i nevojshëm për gërmime masive, hapjen dhe formimin e trupit të rrugës, kanaleve dhe skarpatave, si dhe për ngarkimin e materialeve. Sistemi me zinxhir siguron stabilitet dhe aftësi pune në terrene të vështira.

6. Eskavator me goma – 2 (dy) copë

Kërkohet për gërmime, sistemime dhe ngarkim materialesh, veçanërisht në zona ku nevojitet lëvizshmëri më e lartë e makinerisë. Sasia prej 2 (dy) copësh mundëson angazhimin në fronte të ndryshme të punimeve.

7. Fadromë me goma – 1 (një) copë

Kërkohet për ngarkimin, zhvendosjen dhe sistemimin e materialeve të ndërtimit dhe inerteve, pastrimin e zonës së punës dhe furnizimin e proceseve të ndryshme me material.

8. Minifadromë – 1 (një) copë

Kërkohet për ngarkim, transport të shkurtër dhe sistemim materialesh në zona me hapësirë të kufizuar, ku përdorimi i makinerive me përmasa të mëdha është i vështirë.

9. Kontenier kantieri – 1 (një) copë

Kërkohet për organizimin funksional të kantierit dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për administrimin e dokumentacionit, personelin teknik dhe/ose ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme gjatë zbatimit të kontratës.

10. Gjenerator kantieri – 1 (një) copë

Kërkohet për sigurimin e furnizimit të pavarur me energji elektrike për pajisjet dhe proceset e punës në ato zona ku furnizimi nga rrjeti elektrik mungon ose nuk është i mjaftueshëm.

11. Betoniere kantieri – 2 (dy) copë

Kërkohen për përgatitjen në kantier të sasive të betonit dhe llaçit të nevojshme për punime lokale dhe elemente ndihmëse. Dy pajisje mundësojnë furnizimin e fronteve të ndryshme të punës.

12. Vibruues betoni – 2 (dy) copë

Kërkohen për ngjeshjen e betonit të freskët, eliminimin e boshllëqeve të ajrit dhe sigurimin e kompaktësisë së kërkuar të elementeve prej betoni. Sasia prej 2 (dy) copësh lidhet me mundësinë e kryerjes së betonimeve në më shumë se një front pune.

13. Vibrator pllakash – 1 (një) copë

Kërkohet për ngjeshjen e shtresave të materialeve granulare, mbushjeve dhe sipërfaqeve të kufizuara, veçanërisht në zona ku përdorimi i rulave të mëdhenj nuk është praktik.

14. Matrapik – 2 (dy) copë

Kërkohen për prishjen dhe çmontimin e shtresave apo elementeve ekzistuese prej betoni, asfalti ose materialesh të tjera të forta, si dhe për ndërhyrjet lokale gjatë realizimit të punimeve.

15. Karroca dore – 5 (pesë) copë

Kërkohen për transportin manual të materialeve në distanca të shkurtra dhe në zona ku mjetet mekanike nuk mund të aksesojnë. Numri prej 5 (pesë) copësh mundëson përdorimin e tyre nga grupe të ndryshme pune.

16. Nivelues betoni – 1 (një) copë

Kërkohet për nivelimin dhe përfundimin e sipërfaqeve prej betoni, duke ndihmuar në realizimin e kuotave, rrafshësisë dhe cilësisë së kërkuar të sipërfaqes.

17. GPS Base and Rover – 1 (një) komplet

Kërkohet për punimet topografike, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave, piketimin e aksit dhe elementeve të projektit, kontrollin e pozicionimit të punimeve dhe verifikimin e realizimit të tyre sipas të dhënave të projektit.

18. Autobitumatrice – 1 (një) copë

Kërkohet për shpërndarjen uniforme të materialit bituminoz gjatë realizimit të shtresave lidhëse dhe proceseve të tjera teknologjike që paraprijnë ose shoqërojnë asfaltimin.

19. Autobot uji – 1 (një) copë

Kërkohet për furnizimin me ujë të kantierit, lagështimin e materialeve gjatë ngjeshjes, reduktimin e pluhurit dhe pastrimin e sipërfaqeve sipas nevojave teknologjike të punimeve.

20. Asfaltoshtruese – 1 (një) copë

Kërkohet për shtrimin mekanik dhe uniform të përzierjeve asfaltike, kontrollin e trashësisë dhe profilin të shtresës dhe realizimin e sipërfaqes rrugore sipas parametrave të projektit.

21. Asfaltoprerëse – 1 (një) copë

Kërkohet për prerjen e kontrolluar të shtresave ekzistuese të asfaltit gjatë ndërhyrjeve, riparimeve, lidhjeve me shtresat ekzistuese dhe përcaktimit të kufijve të zonave ku do të kryhen punime.

22. Autobetonierë – 2 (dy) copë

Kërkohen për transportimin e betonit të gatshëm nga impianti deri në kantier duke ruajtur homogjenitetin dhe karakteristikat e përzierjes. Dy mjete ndihmojnë në sigurimin e vazhdimësisë së furnizimit gjatë proceseve të betonimit.

23. Kamion pompë betoni – 1 (një) copë

Kërkohet për pompimin dhe vendosjen e betonit në elemente ose pozicione ku shkarkimi i drejtpërdrejtë nga autobetoniera është teknikisht i vështirë ose i pamundur, duke mundësuar realizimin e kontrolluar të procesit të betonimit.

24. Rimorkiator – 1 (një) copë

Kërkohet për transportimin dhe zhvendosjen e makinerive të rënda dhe pajisjeve të kantierit që nuk mund ose nuk duhet të qarkullojnë në mënyrë të pavarur në rrugë, duke garantuar mobilizimin e tyre sipas nevojave të fronteve të punës.

25. Rul hekur–hekur – 1 (një) copë

Kërkohet për ngjeshjen e shtresave rrugore dhe veçanërisht gjatë proceseve të asfaltimit, me qëllim arritjen e dendësisë, rrafshësisë dhe parametrave teknikë të përcaktuar në projekt dhe specifikimet teknike.

26. Rul gomë–hekur – 1 (një) copë

Kërkohet për proceset e ngjeshjes së shtresave rrugore dhe asfaltike, duke plotësuar procesin teknologjik të kompaktimit dhe duke kontribuar në arritjen e dendësisë dhe cilësisë së kërkuar të shtresave.

Përfundim: Makineritë, mjetet dhe pajisjet e mësipërme janë përcaktuar në funksion të proceseve kryesore të realizimit të objektit, përkatësisht: **gërmimeve dhe punimeve të dheut, transportit të materialeve, ngarkim-shkarkimit, realizimit të rrjeteve dhe drenazhimeve, punimeve të betonit dhe betonarmesë, punimeve topografike, ndërtimit të shtresave rrugore, asfaltimit, ngjeshjes dhe organizimit të kantierit.**

Përcaktimi i sasive minimale synon të garantojë kapacitetin teknik dhe operacional të operatorit ekonomik, vijueshmërinë e proceseve të punës dhe mundësinë e zhvillimit paralel të fronteve të ndryshme, në përputhje me grafikun dhe afatin e realizimit të kontratës.

Kërkesa për disponimin e mjeteve **në pronësi ose me qira** synon të vërtetojë disponueshmërinë reale të kapaciteteve teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, pa e kufizuar plotësimin e kriterit vetëm te operatorët që i kanë këto mjete në pronësi.

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 40* copë
- Jelek për kantier fosforoshent - *jo më pak se 40* opë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 4* copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 4* copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*

- ❑ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**
- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
 - 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
 - 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
 - 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT